



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, më 29 shtator Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi. Ai konstatoi se ekziston ende rreziku që i akuzuari të arratiset, pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë krime të tjera.

Në vendimin e tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton afatet që i janë vendosur Prokurorisë dhe Mbrojtjes për të avancuar përgatitjet për gjykim dhe vëren se janë përmbushur hapa të rëndësishëm proceduralë për kalimin e dosjes gjyqësore te trupi gjykues brenda fundit të këtij viti. Bazuar në këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi nuk është disproporcional.

Versioni i redaktuar publik i këtij vendimi doli javën e kaluar dhe gjendet, së bashku me parashtrimet e tjera të protokolluara, në faqen e internetit të DHSK-së.

Në të njëjtën çështje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në konferencën mbi ecurinë e çështjes më 8 shtator 2022, i kërkoi Zyrës Administrative të komunikonte me autoritetet përgjegjëse në Kosovë lidhur me mundësinë e caktimit të një personi kontakti për marrjen e kërkesave të ekipeve të Mbrojtjes për informacion, bashkëpunim apo ndihmë. Lidhur me këtë kërkesë, të premtën më 7 tetor, Zyra Administrative njoftoi se Ministria e Drejtësisë në Kosovë shprehu pajtimin me propozimin dhe dërgoi të dhënat e personave të caktuar për kontakt.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, më 6 tetor, Paneli i Apelit nxori vendim lidhur me kërkesat e ekipeve të Mbrojtjes ku pretendojnë se ZPS-ja nuk ka dorëzuar përgjigje ndaj apelit të tyre në përputhje me Rregulloren. Paneli i Apelit nuk u pajtua me këtë pretendim dhe për rrjedhojë e rrëzoi pretendimin e tyre. Dje, Paneli i Apelit refuzoi kërkesat e ekipeve të Mbrojtjes për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve në kundërpërgjigjet e tyre dhe i ktheu të dyja kundërpërgjigjet pasi tejkalonin numrin e lejuar të fjalëve. Paneli i Apelit urdhëroi z. Gucati dhe z. Haradinaj të ridorëzojnë kundërpërgjigjet brenda pesë ditësh nga marrja e urdhrit dhe të sigurojnë që janë në pajtim me rregullat përkatëse.

Në të njëjtën çështje, më 7 tetor, Zyra Administrative njoftoi Panelin e Apelit se z. Gucati pagoi gjobën prej 100 eurosh që u vendos si pjesë e dënimit të tij.

Në çështjen *Pjetër Shala*, Trupi Gjykues ka caktuar datat 18-20 tetor për konferencat përgatitore për gjykim, ndërsa 21 tetorin si datë rezervë. Ndër pikat që do të diskutohen janë hetimet, nxjerrja e provave dhe





zhvillimi i gjyqimit. Përpara fillimit të konferencës për përgatitore për gjykim, mbrojtësi i viktimave dhe Zyra Administrative i kanë paraqitur parashkrime me shkrim Trupit Gjyqës.

Seancat publike transmetohen me 45 minuta vonesë në faqen e internetit të DHSK-së, në shqipë, serbishtë dhe anglishtë. Personat e interesuar në Hagë mund t'i ndjekin seancat nga galeria për publikun e Gjykatës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

